



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - URED PREDSEDNIKA

UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 04/2017
PËR CAKTIMIN E SHPENZIMEVE TË
REPREZENTACIONIT NË PRESIDENCË

Prishtinë, 26.10.2017



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – URED PREDSEDNIKA

Sekretari i Zyrës së Presidentit,

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), dhe nenit 18 të Rregullores (P) nr. 02/2016, për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (SZP) NR. 04/2017
PËR CAKTIMIN E SHPENZIMEVE TË REPREZENTACIONIT NË
PRESIDENCË**

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen shpenzimet e reprezentacionit për zyrtarët e Presidencës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga zyrtarët dhe njësitë përkatëse të Presidencës.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **President** - nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Presidenti që i ka kaluar mandati** - nënkupton Presidentin që i ka kaluar mandati, i cili gëzon privilegje sipas Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - 1.3. **Sekretar** - nënkupton Sekretarin e Zyrës së Presidentit;
 - 1.4. **Presidencë** - përfshin Kabinetin e Presidentit, Zyrën e Presidentit dhe institucionet e tjera të ndërlidhura;

- 1.5. **Të punësuarit në Kabinet** - nënkupton Shefin e Stafit, Zëvendës shefin e Stafit, Këshilltarët e Presidentit, stafin mbështetës, zyrtarët e sigurisë dhe nëpunësit teknik;
- 1.6. **Drejtor** - nënkupton Drejtorët e Departamenteve Profesionale dhe Mbështetëse, Sekretarin e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe Drejtorin e Njësisë së Auditimit;
- 1.7. **Shpenzimet e Reprerentacionit** - do të thotë të gjitha shpenzimet që bëhen me rastin e kryerjes së detyrave zyrtare për interesa të Presidencës, siç janë drekat, darkat dhe pijet gjatë takimeve të punës me delegacionet të ndryshme;
- 1.8. **Ligji për Presidentin** - nënkupton Ligjin Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009).

KAPITULLI II – E DREJTA PËR SHPENZIM TË REPRERENTACIONIT

Neni 4

E drejta për reprerentacion

1. Të drejtë në shpenzime të reprerentacionit, në kuadër të Presidencës, kanë:
 - 1.1. Presidenti;
 - 1.2. Presidenti që i ka kaluar mandati;
 - 1.3. Këshilltarët e Presidentit;
 - 1.4. Sekretari;
 - 1.5. Drejtorët.
2. Në varësi nga arsyet dhe nevojat e punës, vlera maksimale e shpenzimeve mujore të reprerentacionit, është përcaktuar në Shtojcën një (1) të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 5

Përdorimi i shpenzimeve të reprerentacionit

1. Shpenzimet e reprerentacionit nuk mund të përdorën për qëllime tjera, përveç atyre që janë të përcaktuara në këtë Udhëzim.
2. Të gjitha shpenzimet e reprerentacionit duhet të arsyetohen me fatura përkatëse të nënshkruara nga shpenzuesi i autorizuar sipas këtij Udhëzimi.
3. Faturat përkatëse të cilat nuk janë të nënshkruara nga shpenzuesi i autorizuar sipas këtij Udhëzimi nuk do të pranohen dhe mbulohen nga vetë zyrtari (shfrytëzuesi) në mënyrë individuale.

Neni 6

Shpenzimet e reprerentacionit dhe tejkalmi i tyre

1. Shpenzimet e reprerentacionit nuk mund të akumulohen dhe vlera e shpenzimeve mbyllet në ditën e fundit të muajit kalendarik.
2. Shpenzimet e reprerentacionit të cilat e tejkalojnë shumën e caktuar sipas këtij

Udhëzimi, mbulohet nga vetë zyrtari (shfrytëzuesi) në mënyrë individuale.

Neni 7

Shpenzimet e reprezentacionit për komisionet, grupet punuese, takimet e veçanta dhe kategoritë tjera

1. Udhëheqësve të komisioneve dhe grupeve punuese të formuara me vendim të Presidentit apo Sekretarit u lejohen shpenzimet e reprezentacionit pas aprovimit nga Sekretari.
2. Takimet e veçanta të grupeve të ndryshme, të cilat nuk janë themeluar me vendime përkatëse të Presidentit apo Sekretarit, duhet marrë paraprakisht miratimin e Sekretarit për shpenzimet eventuale të krijuara.
3. Kërkesat për shpenzimet të kategorive të veçanta nga Kabineti i Presidentit lejohen nga Zëvendës shefi i Stafit dhe më pastaj dërgohen për miratim nga Sekretari.
4. Zyrtari përgjegjës për përgatitjen e versionit fillestar të projekt aktit normativ, i caktuar në pajtim me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ (SZP) nr. 03/2017 për shërbimet juridike në Presidencë, ka të drejtë në shpenzime të reprezentacionit në shumën e barasvlershme për drejtorin, për aktin përkatës. Nëse shpenzimet tejkalojnë shumën e përcaktuar atëherë veprohet në pajtim me paragrafin një (1) të këtij neni.
5. Kërkesat për aprovimin e shpenzimeve të reprezentacionit, sipas paragrafit një (1) të këtij neni bëhet në pajtim me shtojcën dy (2) të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

Ekzekutimi i pagesës

Ekzekutimi i pagesës, për shpenzimet e reprezentacionit të përcaktuara në Shtojcën një (1) të këtij Udhëzimi kryhet nga Departamenti i Administratës dhe Buxhetit në kuadër të Zyrës së Presidentit, në baza mujore, pas pranimit të faturës për shërbimin e kryer.

KAPITULLI III - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Planifikimi i shpenzimeve të reprezentacionit

Divizioni për Buxhet dhe Financa duhet të planifikoj shpenzimet e reprezentacionit sipas këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 10

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.02/2015 për Caktimin e Shpenzimeve të Reprezentacionit për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me Nr. Prot. 1314, e datës 31.12.2015.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga ana e Sekretarit.

Fehmi Mehmeti,

u.d. Sekretar i Zyrës së Presidentit

Prishtinë, 26.10.2017

Shtojca 1: Vlera e shpenzimeve të reprezentacionit



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - URED PREDSEDNIKA

Vlera e shpenzimeve të reprezentacionit

Pozita	Limiti Mujor
Zyrtari i lartë ekzekutiv në emër të Presidentit	I papërcaktuar
Presidenti që i ka kaluar mandati	Deri 100 €
Shefi i Stafit dhe Zëvendës Shefi i Stafit	Deri 100 €
Këshilltari i Presidentit	Deri 60 €
Sekretari	Deri 80 €
Drejtori	Deri 60 €

Shtojca 2: Kërkesa për aprovimin e shpenzimeve të reprezentacionit



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - URED PREDSEDNIKA
EMËRTIMI I DEPARTAMENTIT PËRKATËS

DATË:	dita.muaji.viti
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	z/znj. Emri MBIEMRI – Sekretar i Zyrës së Presidentit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z/znj. Emri MBIEMRI – Drejtor i Departamentit përkatës
NGA/OD/FROM:	Emri dhe MBIEMRI - Udhëheqës i Komisionit.../Grupit punues...
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për aprovimin e shpenzimeve të reprezentacionit

I/E nderuari z.znj Sekretar/e

Në pajtim me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (SZP) nr. 04/2017 për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për zyrtarët e Presidencës (26.10.2017), kërkojë aprovimin e Juaj për shpenzimet e reprezentacionit për takimet e Komisionit.../Grupit punues... të formuar me Vendimin e të Presidentit/Sekretarit (Nr. Data).

Opsioni 1: Shpenzimet janë të nevojshme për mbulimin e pijeve për takimet që parashihen të mbahen gjatë muajit/ve dhe nuk do të kalojnë shumë prej 60 eurove.

Opsioni 2: Shpenzimet janë të nevojshme për mbulimin e punëtorisë ku do të përfshihet dreka dhe pijet për takimin i cili do të mbahet më DD/MM/VV.

Me respekt!

Aprovohet:

Nuk aprovohet:

Nënshkrimi i Sekretarit:

Nënshkrimi i Sekretarit: